

## Pikëtakime dhe mospërkime në marrëdhënien midis strukturës argumentore dhe valencës së foljes në gjuhën shqipe

Brikena Liko

Faculty of History and Philology, University of Tirana, Editor, Academy of Sciences of Albania, Tirana, Albania

### Abstract

Pavarësisht se valenca dhe struktura argumentore e një fjale janë lidhur gjithmonë me konceptin përbërës "i domosdoshëm", gjuha paraqet fakte të cilat e hedhin poshtë këtë "domosdoshmëri", pasi pavarësisht numrit të valencës së një fjale, dalin raste kur jo të gjithë argumentët e mundshëm realizohen dhe sërish frazat janë të pranueshme gramatikisht dhe kuptimisht. Në gjuhën shqipe, për shkak të optimit të saj të zhvilluar, këto mospërkime janë më të theksuara, sepse shpesh përbërësit mund të nënkuptohen edhe pa u shprehur. Qëllimi i këtij artikulli është të hulumtojë pikërisht cilat janë variantet e shfaqjes së kësaj lloji mospërputhjeje në foljet e gjuhës shqipe dhe cilat janë arsyet në këtë gjuhë që sjellin këtë mospërkim midis "të domosdoshmes" dhe "të mundshmes", si dhe valencës kuptimore dhe valencës gramatikore.

**Keywords:** valencë semantike, valencë gramatikore, strukturë argumentore

### 1. Introduction

#### Hyrje

Me strukturë argumentore të një fjale është kuptuar numri i argumentëve që merr ajo, shprehja e tyre sintaksore dhe lidhja kuptimore që vendosin argumentët me atë fjalë. Kjo strukturë argumentore varet nga kuptimi i foljes dhe nga lloji i veprimtimit apo i gjendjes që shpreh fjala (Haegeman, 1994: 43) <sup>[9]</sup>. Ajo është një dukuri leksikore, semantike e morfosintaksore që lidhet ngushtë me tiparin e valencës. Ka diskutime për njësitë leksikore që mund të marrin argumentë, por është pranuar përgjithësisht se numri i tyre lidhet me valencën dhe se qoftë argumentët, qoftë valenca lidhen me fjalët që kanë predikativitet. Ndaj gjithë ato fjalë që kanë valencë, kanë edhe një strukturë argumentore. Të tilla janë foljet, disa emra dhe disa mbiemra <sup>[1]</sup>.

### 2. Struktura argumentore sipas drejtimeve të ndryshme gjuhësore

Koncepti i strukturës argumentore i ka fillimet në 1960 të gramatika transformuese dhe është rimarrë në 1980 në teorinë e drejtimit dhe lidhjes. Ajo është trajtuar ndër vite nga studiues të drejtimeve të ndryshme gjuhësore (p.sh. Gruber, 1965; Jackendoff, 1972; Chomsky, 1981; Gelderen, 2012; Hale & Keyser, pa vit; Borer, 2003; Harley, 1995; etj.) <sup>[8, 2, 12]</sup>. Po të bëhet një vështrim i evoluimit të këtij koncepti që nga fillimi i përdorimit të tij deri sot, do të vihet re se ka disa ndryshime midis grupeve të gjuhëtarëve dhe drejtimeve që ata përfaqësojnë. Disa e kanë lidhur strukturën argumentore të

fjalës me tiparet leksikore a semantike të asaj fjale, të tjerë e kanë lidhur me anën sintaksore apo kontekstet ku shfaqet ajo. Në gramatikën gjenerative të Chomsky-t struktura argumentore e një fjale luan një rol shumë të rëndësishëm në ndërtimet dhe konfigurimet e mundshme në të cilat mund të shfaqet ajo fjalë. Grimshaw (1990) mbron mendimin se struktura argumentore e një fjale përcaktohet prej kuptimit të saj dhe se struktura argumentore e një emri vjen nga ajo e foljes bazë nga i cili e ka prejardhjen. Ken Hale and Jay Keyser (pa vit) e përkufizojnë strukturën argumentore si një konfigurim sintaksor që projektohet nga një njësi leksikore. Sipas tyre ajo është sistemi i lidhjeve strukturore midis kokëve (bërthamave) dhe argumentëve të lidhur me to. Ndërsa Laura A. Michaelis, (përfaqësuese e drejtimit "konstruksionist") <sup>[2]</sup>, ka mbrojtur qëndrimin se struktura argumentore e foljeve nuk vjen nga shprehja e paraqitjes së saj semantike (2012: 546). Sipas saj, janë foljet që i licencojnë argumentët. Në qasjen e saj, rolet semantike ekzistojnë vetëm në rrjetën theta dhe nuk ka hierarki të atyre roleve semantike që janë në gjendje të caktojnë funksione gramatikore në shumicën e strukturave argumentore. Sipas saj, rrjeta theta shpreh vetëm ato role semantike që luajnë rol në përmbushjen e valencës së foljes. Kurse, sipas konstruksionistëve të rinj, për të cilët po përmendim si përfaqësues Hagit Borer-in (2003) <sup>[2]</sup>, argumentët nuk kanë të bëjnë me vetë fjalën, por me lidhjen që vendos ajo fjalë me kokat funksionale të sintagmës foljore. Për këto dy qëndrime, leksikalist dhe konstruksionist, Marantz-i (2012) <sup>[17]</sup> është shprehur se i pari thekson rolin e foljeve në projektimin e strukturës sintaksore prej strukturës së informacionit që gjendet brenda foljes, ndërsa i dyti

1. <sup>1</sup> Ka edhe parafjalë me valencë që kanë një strukturë argumentore. Haegeman trajton mbiemrat me strukturë argumentore dhe parafjalët. P.sh. Parafjala në ka dy argumentë, ndërsa parafjala midis merr tri argumentë (Haegeman: *Introduction to Government and Binding Theory...* 1994, f. 48). Mirëpo natyrshëm lind pyetja: nëse themi se predikatët kanë strukturë argumentore dhe valencë, a mund të konsiderohen parafjalët predikatë?

2. <sup>2</sup> Në studimet e quajtura *konstruksioniste*, pas 1990 është vënë në pikëpyetje mendimi se struktura argumentore e një fjale është një tipar leksikor i asaj fjale, ata mendojnë se ajo varet edhe nga konteksti, pasi e njëjta fjalë në kontekste të ndryshme mund të ndryshojë strukturën argumentore.

thekson rolin e sintaksës në ndërtimin e kuptimeve që tradicionalisht i janë veshur strukturës argumentore.

Në teorinë e lidhjes dhe drejtimit, nëse një folje është kalimtare apo jokalimtare varet nga lloji i veprimit apo gjendjes që ajo shpreh, nga kuptimi i saj. Argumentet janë pjesëmarrësit minimalë që përfshihen në veprimtarinë apo gjendjen e shprehur nga predikati, ndërsa struktura argumentore e foljes përcakton se cilat elemente të fjalisë janë të detyrueshme (Haegeman, 1994: 43–46) <sup>[9]</sup>. Nëse një folje shpreh një veprimtari që kërkon dy argumentë, atëherë duhet të jenë të paktën dy përbërës në fjalë që t'i përmbushin ata. Strukturë argumentore u është njohur edhe parafjalëve, si p.sh. parafjala në kërkon dy argumentë dhe *midis* që kërkon tri.

Për valencën dhe strukturën argumentore në gjuhën shqipe ka pasur studime të posaçme apo edhe të pjesshme në kuadër të një objekti tjetër studimi nga gjuhëtarët e studiuesit që janë orientuar edhe kah drejtimi gjenerativ i studimit të gjuhës, si: Buxheli (2007) <sup>[5]</sup>, Dhima (2007) <sup>[7]</sup>, Turano–Koleci (2011) <sup>[21]</sup>, Koleci (2013) <sup>[13]</sup>, Kananaj (2015) <sup>[11]</sup>, Mita (2005) <sup>[19]</sup>, Çeliku (2012) <sup>[6]</sup> etj.

### 3. Marrëdhënia dhe pikëprerjet midis strukturës argumentore dhe valencës të foljes

#### 3.1 Diskutimet mbi mospërkimet e strukturës argumentore dhe valencës

Nga përkufizimet e mësipërme vihet re se disa argumentë mund edhe të mos jenë të realizuar, gjë që në pamje të parë bie ndesh me përkufizimin se ata janë "të domosdoshëm". Por kjo zgjidhet nëse me "të domosdoshëm" kuptojmë realizimin e tyre fonetik (ose sintaksor po t'i referohemi funksionit). Për shpjegimin e kësaj duhet ta lidhim me konceptin e valencës. Ka studime që kanë bërë *dallimin e strukturës argumentore nga koncepti i valencës*. Christopher D. Manning dhe Ivan A. Sag (1998, 1999) janë ndër ata studiues që mbrojnë mendimin se ka ndryshim midis strukturës argumentore të një fjale dhe valencës së saj. Në kuadër të objektit tonë, qëndrimin e tyre mund ta përmbledhim shkurt duke thënë se valenca është mundësia që kanë fjalët për të marrë argumentë, ndërsa argumentët kanë të bëjnë me realizimin konkret e përmbushjen e valencës. Të tjerë gjuhëtarë që kanë theksuar këtë dallim midis strukturës argumentore të fjalës dhe konceptit të valencës mund të përmendim: Bresnan dhe Zaenen (1990) <sup>[4]</sup>, Bresnan (1995) <sup>[3]</sup>, Alsina (1996) <sup>[1]</sup> etj.

Ka studime të tjera që trajtojnë çështjen e ndryshimit të valencës së një zëri leksikor, dukuri të emërtuar si "*valence change*" (Martin Haspelmath & Thomas Müller-Bardey, 2001), duke e justifikuar këtë dukuri me kuptimet të ndryshme të së njëjtës fjale apo për nuancat kuptimore që varen nga konteksti në të cilin është përdorur ajo fjale.

Ky është edhe rasti i parë i një lloji mospërkimi (të paktën në dukje) i strukturës argumentore me valencën e një foljeje. Themi "të paktën në dukje", sepse ato struktura argumentore apo valenca mund të lidhen me kuptime të ndryshme të së njëjtës folje.

Por duhet përmendur edhe që valenca është tipar i një teme trajtëformuese të foljes, jo i një trajte foljore të veçantë, ndaj eptimi (edhe pasivizimi) i saj nuk e ndryshon valencën e saj (Christian Lehmann; Elisabeth Verhoeven, 2006: 469). Ndaj, në këtë pikë do të sillnim rastin kur e njëjta folje, me të njëjtin kuptim mund të marrë numër të ndryshëm argumentësh.

Pra, nisur nga ajo që u shtrua teorikisht më sipër, mbi bazë të fakteve të shqipes shohim si paraqitet dallimi midis numrit të valencës, strukturës argumentore dhe realizimit konkret të këtyre argumentëve. Nga shqyrtimet e shembujve janë vënë re disa konfigurime të ndryshme që tregojnë se cilët janë faktorët që ndikojnë në raportin midis valencës dhe strukturës argumentore:

#### 3.2 Dallimi i valencës dhe strukturës argumentore sipas kuptimit ose nuancës kuptimore: e njëjta fjale, për të njëjtin përdorim shfaqet me dy struktura të ndryshme argumentore.

a. Unë flas.

b. Unë u flas studentëve.

Ku e njëjta folje paraqitet me dy struktura të ndryshme argumentore:

flas [SE<sub>kryefjalë</sub>, +human, veprues] dhe

flas [SE<sub>kryefjalë</sub>, +human, veprues; SE<sub>kundrinor</sub> i zhdrejtë, +human, përfitues].

Vëmë re se të dyja variantet e fjalisë janë të pranueshme dhe folja është e njëjtë. Folja flas, që është folje njëvalente, del në rastin e parë me një argument të jashtëm, me funksionin e kryefjalës të realizuar me një sintagmë emërore ku emri kokë duhet të ketë tiparet +human dhe rolin tematik të vepruesit. Mirëpo në rastin e dytë e njëjta folje paraqitet dyvalente, pasi përveç argumentit të jashtëm, merr edhe një argument të brendshëm, kundrinorin e zhdrejtë që realizohet me një emër në dhanore dhe që ka tiparet +human dhe rolin tematik të përfituesit. Nëse do të thoshim se folja është 2-valente, atëherë si është e mundur që në fjalinë e parë a. ajo ka vetëm një argument të realizuar dhe sërish fjalia është e pranueshme?

I shtojmë argumente të tjera qëndrimit tonë duke e parë dukurinë në kuadrin e Teorisë së Drejtimit dhe të Lidhjes (TDL). Në TDL struktura argumentore e një foljeje përcakton se cilat elemente të një fjalie janë të detyrueshme. Nëse një folje shpreh një veprimtari që përfshin 2 pjesëmarrës, duhet patjetër të ketë të paktën 2 përbërës në fjalë që të marrin shprehjen e këtyre dy argumentëve (Haegeman, 1994: 44) <sup>[9]</sup>. Në pamje të parë, duket sikur ky përkufizim rrëzon dallimin e numrit të argumentëve me numrin e valencës, pasi kur përdoret fjala "e detyrueshme", do të thotë se të gjitha valencat duhet të plotësohen, pra numri i valencës me numrin e argumentëve duhet të përkojë. Në këtë rast do të thuhej se koncepti i ndryshimit të valencës së një fjale lidhet vetëm me ndryshimin e kuptimit (apo nuancave kuptimore) të asaj fjale. Mirëpo, nëse është kështu, çfarë mund të thuhet në rastet si ai i foljes *qep*, e cila mund të dalë në këto tri variante:

a. Unë qep.

b. Unë qep një fustan.

c. Unë i qep një fustan vajzës sime të vogël.

Po t'i referohemi përkufizimit "e domosdoshme" është vetëm kryefjala, pra folja sipas këtij përkufizimi do të ishte njëvalente dhe kërkon domosdoshmërisht vetëm bërësin e veprimit <sup>[3]</sup>, pësuesi dhe përfituesi mund të mos jenë të

3. <sup>3</sup> Pa u futur thellë në çështjet e tipareve të argumentëve dhe roleve tematike duam të theksojmë se është e vështirë të përcaktosh, aq më tepër shkurt dhe me tiparet +/- pjesëmarrësit në një veprimtari apo gjendje që tregon një folje. Në rastin konkret, "bërësi" ose realizuesi i veprimit "qep" jo detyrimisht duhet të ketë tiparin [+frymor], sepse në shembullin: *Kjo makinë qepëse nuk qep mirë.*, pavarësisht se në lëvizje e vë një veprues me tiparet [+frymor], por në realizimin konkret nuk mund ta mohojmë se veprimi i komanduar kryhet nga një makineri me këtë aftësi. Pra, tipari që

pranishëm domosdoshmërisht.

Sipas këtij arsytimi, kundrinori i drejtë në fjalinë e dytë dhe kundrinori i drejtë dhe ai i zhdrejtë në fjalinë e tretë do të dilnin si përbërës jo të domosdoshëm. Duke mos qenë të tillë do të thotë se nuk plotësohet një nga kriteret më të rëndësishme që duhet të plotësojë një përbërës për t'u quajtur i tillë. Dhe në këtë rast kemi të bëjmë me të njëjtin kuptim të së njëjtës folje. A mund të themi se folja *qep* është folje njëvalente?

Haegeman thotë se, edhe në ato raste kur ky argument nuk është i realizuar fonetiki, ai është i nënkuptuar. Sipas këtij pohimi, në rastin e mësipërm, në shembullin b. do të thoshim se, meqë nuk është shprehur një argument i tretë, nënkuptohet se mbetet *vetes* ose *dikujt*. Por a bie sërish kjo në kundërshtim me përkufizimin e strukturës si “përbërësit e domosdoshëm...”, meqenëse ai nuk është i realizuar? Kësaj pyetjeje i jep përgjigje dallimi i dy llojeve të valencës: valencës sintaksore dhe valencës kuptimore. Valenca sintaksore është gjithmonë e shprehur, i kërkon të gjithë pjesëmarrësit të pranishëm dhe të realizuar fonetiki.

### Unë punoj. / Punoj.

Në këtë rast, folja, si valencë sintaksore ka vetëm një, kërkon shprehjen e një elementi që ta plotësojë atë (kryefjala), në të dyja rastet e realizuar fonetiki nëpërmjet përemrit dhe elementeve të eptimit në rastin e parë dhe nëpërmjet elementeve të eptimit në rastin e dytë.

Të njëjtën fjali, të njëjtën folje, po ta shohim nga pikëpamja kuptimore, do të vërejmë se, pavarësisht se nuk është e shprehur, folja *punoj* i referohet kryerjes së një detyre, të një veprimi, pra është diçka që "kryhet" gjatë këtij procesi, një lloj rezultati i veprimit, apo një lloj përfituesi. Prandaj kemi fjali si:

### Unë punoj tokën.

Kjo është valenca kuptimore, e cila mund të mos realizohet, por nënkuptohet dhe, nga pikëpamja pragmatike, në rast se folësi dëshiron ta theksojë e realizon atë.

E njëjta gjë vërehet edhe me folje si *ha*, *pi*, *fle* etj., të cilat do të shihen më tej në trajtimin e strukturës argumentore, si folje që kanë disa role tematike që nuk ia caktojnë asnjë sintagme emërore dhe e kanë brenda tyre qoftë argumentin, qoftë rolin tematik.

**3.3 Ndryshimi për shkaqe gramatikore, kur kemi kalim të foljes nga forma veprare në formën joveprare:** në këtë rast, kundrinori i drejtë bëhet kryefjalë, kryefjala bëhet kundrinor i zhdrejtë me parafjalë që nuk bën pjesë tek argumentët, por tek adjunktët dhe rrjedhimisht nga dy argumentë mbetet një, vetëm kryefjala:

*Unë derdh ujin.*

*Uji u derdh.*

?*Uji u derdh nga unë.*

Vihet re qartësisht se si në rastin e parë janë të domosdoshëm të dy argumentët, ndërsa në rastin tjetër, kalimi në joveprare

kërkon vetëm një argument, pasi *nga unë* nuk është më një argument, pasi nuk është më i domosdoshëm, madje një folës i lindur i shqipes do ta ndiente si të tepërt. Autori vërtet logjikisht është i nënkuptuar në njëfarë mënyre (pasi uji që të derdhet ka nevojë për një "shkak", lëvizje apo autor), por ai nuk është i domosdoshëm të realizohet fonetiki.

derdh<sub>veprare</sub> [SE<sub>kryefjalë</sub>, +human, veprues; SE<sub>kundrinor</sub> i drejtë, jofrymor, + i lëngët, pësues]

u derdh<sub>joveprare</sub> [SE<sub>kryefjalë</sub>, jofrymor, + i lëngët, pësues; - ]

Mirëpo, në një situatë tjetër, si më poshtë, përbërësi *nga unë* mund të cilësohet i domosdoshëm nga folësi, ndaj vetë shqiptimi i këtij përbërësi me emfazë, do ta bënte atë të domosdoshëm:

*Uji u derdh NGA UNË / PREJ MEJE, jo nga vajza / PREJ VAJZËS.*

Edhe pse me këtë shembull nuk është e zakonshme, kjo dukuri është më e qartë në raste si:

*Dokumenti u nënshkrua prej të dyve / jo vetëm nga njëri.*

Ajo është lidhur edhe me dukurinë e kontrastit <sup>[4]</sup>, por këtu nuk do të ndalemi në këtë pikë.

**3.4 Dallimi që lind në përdorimin pragmatik nga nevojat e folësit** për të theksuar e për të realizuar fonetiki një argument të caktuar edhe kur ai në kontekste të tjera mund të nënkuptohet nga kuptimi i foljes në fjalë. Ky është rasti i markimit pragmatik, vlerës pragmatike të fjalës (shih për këtë koncept: Renzi; Salvi; Cardinaletti, 1991, f. 130) <sup>[20]</sup> dhe lidhet me ndarjen aktuale të gjymtyrëve.

Edhe kjo dukuri që renditëm më sipër mund të shpjegohet me dallimin e valencës semantike nga ajo gramatikore, pra mundësia e një foljeje për t'i marrë ata argumentë dhe domosdoshmëria ose jo për t'i realizuar konkretisht.

Pra, përveç argumentit të dallimit të dy llojeve të valencës, çështja e domosdoshmërisë së përbërësve në fjali apo të pranisë a mungesës së tyre, duhet të shihet edhe në raport me anën pragmatike të fjalisë. Ajo kushtëzohet nga faktorë të brendshëm semantiko-sintaksorë të foljes (struktura argumentore), por edhe nga faktorë pragmatikë të realizimit të thënies në një kontekst të caktuar. Në këto raste përbërësi ka tiparin *+remë*, dhe me anë të elementit të theksuar shpreh një informacion të ri, por edhe për të krijuar kontrast. Pra, kjo ndodh kur një përdorues i gjuhës e konsideron si të rëndësishme ta theksojë (si *remë*) një përbërës të caktuar, shprehja e tij bëhet e domosdoshme.

Kështu është rasti i foljes *qep*, që pamë më sipër, e cila në kuptimin e parë që ka në fjalor na paraqitet me tri struktura argumentore:

a

**a. Unë qep.**[SE<sub>human</sub>, veprues + përfitues]

Në këtë rast kryefjala me tiparin [+human] është edhe veprues edhe përfitues njëkohësisht, përderisa nuk ka elemente të tjera që të tregojnë ndryshe.

**b. Unë qep një fustan. / Qep këmishën.** [SE<sub>frymor</sub>, veprues + përfitues, SE<sub>kallz</sub>, pësues, jofrymor].

Përveç argumentit të jashtëm, si në fjalinë e parë, këtu kemi të shprehur edhe një argument të brendshëm, sintagmë emërore me emër në kallëzore, element që theksohet nga folësi, por që

ndoshta nuk mund ta përmbledhim me një fjalë është "një 'përbërës' me aftësinë e të qepurit". Kjo çështje qëndron edhe për folje të tjera, sidomos kur bëhet fjalë për dallimin e një vepruesi të ndërgjegjshëm dhe të pandërgjegjshëm, por të komanduar.

4. <sup>4</sup> Për kontrastin shih më gjerë: Renzi; Salvi; Cardinaletti, 1991.

nuk e kërkon detyrimisht kuptimi i foljes, siç shihet në fjalinë e parë.

**c. Unë i qep një fustan vajzës sime të vogël.** [SE<sub>frymor</sub>, veprues, SE<sub>kallz</sub>, pësues, jofrymor, SE<sub>dhanore</sub>, frymor, përfitues].

Në këtë rast vihet re se me shprehjen e një argumenti tjetër me rolin tematik të përfituesit, ky rol tematik që në dy rastet e para i vishej argumentit të jashtëm (kryefjalës që kishte rolin tematik të vepruesit edhe të përfituesit), tani i kalon këtij elementi. Në këtë rast theksimi sjell ndryshim kuptimor, pasi në rast mosshprehjeje, si *përfitues* do të mbetej i nënkuptuar *vepruesi*.

Po në të mirë të shpjegimit të kushtëzimit pragmatik, paraqesim shembullin e foljes *fle*:

*Po flija.*

që është fjali plotësisht e pranueshme nga të gjitha pikëpamjet, por që edhe ajo del në formën:

*Do të fle gjumë*<sup>[5]</sup>.

Në këto raste, folësi e realizon argumentin sepse dëshiron të vërë theksin ose të plotësojë, por ky realizim fonetik nuk i shton asgjë kuptimit, madje duket i tepërt si element, pasi vetë folja na e jep këtë informacion (sepse është i vetmi përbërës i dytë me të cilin mund të shoqërohet kjo folje – nuk mund të flihet asgjë tjetër, veç gjumit).

Mirëpo, në rastin e foljeve *ha*, *pi*, pavarësisht se edhe në këto raste në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet se nënkuptohet *ha ushqimin*, dhe *pi lëngje*, shtimi i argumentit të brendshëm këtu mund të sjellë një ndryshim të madh të informacionit që ndoshta do të nënkuptohej natyrshëm po të mos realizohej:

*Po ha. Po pi.*

*Po ha bukë. / Piva ujë, qumësht / çaj etj.*

Po kështu ndodh edhe me foljen *ha* që e ka të nënkuptuar ushqimin, ndaj është e vetëmjaftueshme vetëm me një argument sintaksor:

*Hëngra herët sot.*

*Nuk dua të ha në këtë orë.*

*Nuk ha asnjëherë pas orës 6.*

*Dua të ha.*

Në këto raste, argumenti i jashtëm, kryefjala, është realizuar me anë të elementeve të eptimit të foljes. Nuk është i shprehur dhe nuk është i domosdoshëm një përbërës i dytë, si argumenti që tregon ushqimin. Mirëpo, në rast se konteksti është i tillë që lloji i ushqimit duhet theksuar, sepse është rema dhe është informacion i rëndësishëm për t'u dhënë, atëherë ai bëhet i domosdoshëm. Kështu në shembujt:

*Hëngra vezë për mëngjes.*

*Ndoshta ka ngrënë diçka të prishur.*

*Hëngrem diçka shumë të shijshme.*

është vetë konteksti apo nevoja që ka folësi për ta dhënë apo theksuar ai që e bën të domosdoshëm ose jo një përbërës.

### 3.5 Rast tjetër është ai i ndryshimit midis numrit të valencës dhe llojit të argumentit, pra kur kemi të njëjtën

5. <sup>5</sup> Vëmë re shprehësinë e shqipes, sidomos kur folja nuk ka lidhje prejardhjeje me emrin që shërben si kundrinor. Në shqip kemi *ajo fle gjumë*, ndërsa në anglisht nuk kemi *\*She sleeps sleep*. Këtu mund të quhen tepri, por sërish janë të realizueshme. Këtu mund të përmendim edhe *Ajo e këndoi këngën deri në fund. / Ajo këndoi*.

**valencë**, por jo gjithmonë mbushja e pozicioneve vjen sipas radhës: kryefjalë, kundrinor i drejtë, kundrinor i zhdrejtë, lokativ etj. Kjo vihet re po të shohim dy zëra të ndryshëm me të njëjtën valencë, p.sh. dy folje të ndryshme, por dyvalente që kërkojnë si argumentë të domosdoshëm nga ata që kryejnë funksione të ndryshme sintaksore:

P.sh., edhe folja *flas* (me kuptimin dyvalentor që u përmend më sipër), edhe folja *dua* janë dyvalente. Pavarësisht se ato kanë të njëjtin numër valencash, lloji i argumentit që marrin, është i ndryshëm. Kështu të dyja kërkojnë një argument të jashtëm, kryefjalën, por folja *flas* kërkon një argument – kundrinor të zhdrejtë për të plotësuar valencën e dytë. Ndërsa folja *dua* kërkon si argument të dytë një kundrinor të drejtë.

Unë u *flas* studentëve.

Unë *dua* qetësi.

*flas* [SE<sub>kryefjalë</sub>, +human, veprues; SE<sub>kundrinor</sub> i zhdrejtë, +human, përfitues].

*dua* [SE<sub>kryefjalë</sub>, +human, përjetues; SE<sub>kundrinor</sub> i drejtë, jofrymor, temë]

Në mënyrë të përmbledhur mund të nxirrim dy raste si më poshtë:

Valenca kuptimore mund të përkojë ose jo me atë sintaksore. Ka dy raste:

**1. Valenca kuptimore = valencë sintaksore**, në rastin kur të gjitha valencat janë të detyrueshme që të shprehen si te folja *takoj*, ku është e domosdoshme që të dyja valencat të plotësohen dhe të shprehen, në këtë rast përkon struktura sintaksore me atë argumentore.

**2. Valenca kuptimore ≠ valenca sintaksore** si p.sh. në rastin e foljes *kërkoj*, ku duhet të përmbushen detyrimisht dy valenca: argumentin e jashtëm – kryefjalën dhe argumentin e brendshëm – kundrinorin (i cili theksojmë se në rastin e kësaj foljeje mund të jetë edhe një sintagmë komplementuese). Valenca e tretë është kuptimore, por jo domosdoshmërisht sintaksore (*Unë kërkoja ujë. / Kërkoja të rrija edhe pak*). Ajo mund të realizohet si në rastin e fjalisë: *Vajza i kërkon nënës ujë*. ku kemi edhe kundrinorin e zhdrejtë (që është argument dhe është i domosdoshëm).

### 4. Përfundime

Pas shqyrtimit teorik dhe analizës së shembujve konkretë nga shqipja, mund të arrijmë në disa përfundime. Struktura argumentore e fjalës (këtu e foljes) nuk përkon gjithmonë me valencën e saj, pasi mund të ndodhë që e njëjta folje, me të njëjtën valencë dhe me të njëjtin përdorim të dalë me numër të ndryshëm argumentësh. Rastet e mospërkimeve midis strukturës argumentore dhe valencës së saj paraqiten në disa variante dhe ato vijnë për shkak të kuptimit të foljes, përdorimit pragmatik të saj në një kontekst të caktuar etj. Të gjitha pikëpyetjeve që dalin gjatë këtyre mospërkimeve gjejnë përgjigje në dallimin që duhet bërë midis dy llojeve të valencës, asaj gramatikore dhe asaj semantike.

### 5. Referenca

1. Alsina, A. The role of argument structure in grammar: Evidence from Romance. Stanford: CSLI Publications, Jstore, 1996.
2. Borer H. Exo-skeletal vs. endo-skeletal explanations. In Moore, J. and M. Polinsky (eds). The Nature of Explanation in Linguistic Theory. Chicago: CSLI and



- University of Chicago Press, 2003. [<http://webpace.qmul.ac.uk/hborer/downloads/explanation.pdf>].
3. Bresnan J. Lexicality and Argument Structure, Conference Paris Syntax and Semantic. [<http://web.stanford.edu/~bresnan/paris.pdf>], 1995.
  4. Bresnan JB, Zaenen A. Deep Unaccusativity in LFG. In Grammatical Relations. A Cross-Theoretical Perspective, Dziwirek, K., P. Farrell & E. Mejias-Bikandi (eds.), CSLI Publications, Stanford, CA. 1990, 45-58.
  5. Buxheli L. Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe. Tiranë: Neraida, 2007.
  6. Çeliku M. Sintaksë e gjuhës shqipe - përbërësit sintaksorë. Tiranë: Ilar, 2012.
  7. Dhima, Th. Valenca e emrave dhe çështje të klasifikimit të tyre (hartuar: 2007) në Çështje të sintaksës së gjuhës shqipe (përmbledhje artikujsh). Tiranë: Infbotues. 2013, 75-93.
  8. Gelderen EV. Clause structure – The Three Layers. Arizona State University, Versioni i publikuar në shtator. 2012, 143.
  9. Haegeman, L. Government and Binding Theory. Blackwell, Oxford UK & Cambridge USA, Botimi II. 1998, 1994, 43, 44, 46, 48.
  10. Haspelmath, M. and Müller-Bardey, Th. Valence Change. HSK-Morphology. A Handbook on Inflection and Word Formation, 2001. [<http://wwwstaff.eva.mpg.de/~haspelmt/2005val.pdf>].
  11. Kananaj, A. Rrethori në gjuhën shqipe. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2015, 34, 89.
  12. Ken H, Keyser J. The Basic Elements of Argument Structure, MIT, [shfrytëzuar nga faqja <http://citeseerx.ist.psu.edu/viewdoc/download?doi=10.1.1.116.5572&rep=rep1&type=pdf> në datën 15.08. 2015.] pa vit.
  13. Koleci F. Frazat relative të shqipes. Tiranë. 2013, 28, 52, 53.
  14. Kulikov L, Malchukov A, De Swart P. (Editors). Case, Valency and Transitivity, vëll. 77 i Studies in Language Companion Series, "Transitivity and valency change, Amsterdam/Philadelphia: John Benjamins Publishing Company- 2006, 375-390. ISSN 0165-7763, Part III.
  15. Manning ChD, Sag I. Dissociations between Argument Structure and Grammatical Relations. In Weibelhuth, Gert, Jean-Pierre Koenig and Andreas Kathol (eds.), Lexical And Constructional Aspects of Linguistic Explanation, CSLI Publications. 1999, 63-78.
  16. Manning, Ch.D. and Sag, I. Argument Structure, Valence, and Binding. Nordic Journal of Linguistics. 1998; 21(2):107-144.
  17. Marantz A. Argument Structure and Morphology: Noun Phrases that Name Events, 2012, [<http://web.mit.edu/marantz/Public/Download/KoreaHO.pdf>].
  18. Michaelis LA. Complementation by Construction. In M.J. Hauser *et al.*, (eds.), The Proceedings of the Thirty-second Annual Meeting of the Berkeley Linguistics Society: Parasession on Theoretical Approaches to Argument Structure. Berkeley: BLS, Inc. 2012, 529-549.
  19. Mita J. Hyrje në sintaksën gjenerative. Prishtinë: Shpresa, 2005, 52.
  20. Renzi L, Salvi G, Cardinaletti A. (a cura di). Grande grammatica italiana di consultazione, vol. I (nuova ed.). La frase. I sintagmi nominale e prepositional. Bologna: Il Mulino, 1991.
  21. Turano G, Koleci F. Hyrje në gramatikën gjenerative. Tiranë: SHBLU, 2011.